

TERMAT E REFERENCËS

KOMPANI PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E PODKASTEVE

Projekti: “Granti për mbështetje organizative”

Zbatuar nga: “She Solutions/Ajo Zgjidhje”

Mbështetur nga: "Rrjeti i Grave të Kosovës dhe financuar nga The Sigrid Rausing Trust".

HISTORIKU

OJQ SHE Solutions/AJO Zgjidhje është themeluar me qëllim të fuqizimit të vajzave dhe grave në vendimmarrje, fuqizimit të rolit të gruas në shoqëri dhe në të gjitha fushat. Misioni i SHE Solutions/AJO Zgjidhje është të përkrahë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën pa dallim në baza politike, fetare, moshës apo etnisë. Këtë mision organizata synon dhe punon në vazhdimësi që ta arrij përmes: lobimit, hulumtimeve, organizimit dhe pjesëmarrjes në tryeza të ndryshme si dhe realizimit të intervenimeve të ndryshme vetëm ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë. Intervenime këto si trajnime, mentorime, hulumtime, informime si dhe mbështetje direkte.

QELLIMI DHE OBJEKTIVAT

Përmes projekti për mbështetje organizative, i cili është në përputhje edhe me strategjinë e RRGK-së 2023-2026, përkatësisht me *Avancimin e barazisë gjinore përmes sundimit të ligjit dhe Transformimin e normave gjinore përmes edukimit*. She Solutions/Ajo Zgjidhje në kuadër të këtij projekti përmes një koleksioni të podkasteve (10) të historive/udhëtimeve të grave dhe burrave për nisma individuale dhe kolektive, synojmë të festojmë punën e bërë në arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut përmes një diskutimi të singërt që përhapet nëpër breza, duke theksuar rrugët e ndryshme të suksesit, të pengesave dhe të rrugës ende të mbetur në qëllimin e përbashkët për arritjen e të drejtave universale të njeriut.

Kështu, këtë herë synimi është të iniciojmë një grup podkaste të këtyre grave dhe burrave, duke transmetuar historitë e tyre online, duke i promovuar ato dhe duke i mbledhur të gjithë së bashku në një takim informal si një mënyrë për të festuar punën e tyre, për të bërë një bilanc të një pjese të progresit të bërë dhe për të ofruar një nxitje të re për punën përpara.

PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT

Për të mundësuar përgatitjen dhe realizimin e këtyre podkastave në kuadër të periudhës kohore (shtator-dhjetor 2024), organizata She Solutions/ Ajo Zgjidhje është në kërkim të një kompanie, e cila do të përgatis dhe do të realizojë 10 podkastet me:

*Pionierët e të drejtave të njeriut dhe aktivistet e grave që kanë punuar për çështjet e të drejtave të njeriut dhe barazinë gjinore duke thyer tabu, gratë që punojnë në pajtim në nivelin bazë, regjisorët/skenaristët që përmes punës së tyre artistike promovojnë barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, aktivistet e shoqërisë civile që përmes festivaleve dhe ekspozitave të artit promovojnë barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, gratë në institucione që udhëheqin ndryshimet dhe shtojnë për promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.



Financuar nga
**THE
SIGRID
RAUSING
TRUST**

Përkatesht kërkohet nga kompania që përmes angazhimit të një ekipi profesional teknik të realizojë xhirimin e podcasteve, montimin e podcasteve, postproduksionin, titrimin, siglat, përkthimin dhe promovimin në media sociale.

KUALIFIKIMET

- Subjekti ofertues duhet të jetë i regjistruar dhe licensuar me fushëveprim që përputhet me shërbimet e kërkuara;
- Subjekti ofertues duhet të ketë përvojë të dokumentuar në fushën e kërkuar të shërbimit.

AFATET KOHORE

Kompania pritet të fillojë punën më 2 tetor 2024. Kalendari i përafërt do të jetë si më poshtë:

Shpallja e thirrjes për aplikim	16.09.2024
Afati i fundit për aplikim	30.09.2024
Nënshkrimi i kontratës dhe takimi informativ	02.10.2023
Zhvillimi i podkasteve	Mbetet të konfirmohet

KOHEZGJATJA

Angazhimi në kuadër të kësaj kontrate përfshin periudhën nga 2 tetor 2024 deri më 31 dhjetor 2024.

DORËZIMI I OFERTAVE

Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë:

- Një propozim të shkurtër teknik me shembuj dhe/ose ide për podkastet;
- Një portofolio me punë krahasimore që demonstroi kapacitetet; dhe
- Një propozim financiar.

Ju lutemi dërgoni dokumentet e kërkuara deri me **30.09.2024**, në e-mailin: ojq.she.solution@gmail.com, me titullin “Kompani për përgatitjen dhe realizimin e podkasteve”.

VLERËSIMI I OFERTAVE

Ofertat do të vlerësohen nga një Komision prej tre personave si bazuar në aspektet në vazhdim:

- 40% Përvoja
- 30% Propozimi
- 30% Oferta më e ulët

Vetëm kompanitë e sukseshme do të kontaktohen!

